



Prishtinë, 23, dhjetor 2016
Kodi i ZRRE-së: V_875_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e nenit 8, paragrafët 1 dhe 6, të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e nenit 15 dhe nenit 26 paragrafi 1, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084; dhe
- Kërkesën e Ndërmarrjes Publike - Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Gjakova sh.a. të datës 9 dhjetor 2016, për miratimin e dokumentit: Bilanci Vjetor i Energjisë Termike.

Pas shqyrtimit të dokumentit në fjalë dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur me datë 23 dhjetor 2016, nxori këtë:

VENDIM

I. APROVOHET BILANCI VJETOR I ENERGISË TERMIKE për vitin 2017 i NQ Gjakova sh.a.

Arsyetim

1. Me datë 9 dhjetor 2016, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar draftin final të dokumentit: Bilanci Vjetor i Energjisë Termike për vitin 2017 nga NQ Gjakova sh.a. si bartës i Licencës për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë termike.
2. Pas shqyrtimit të draft-dokumentit "Bilanci Vjetor i Energjisë Termike" të dorëzuar nga NQ Gjakova dhe përmirësimit e plotësimit të tij sipas komenteve të ZRRE-së, Bordi i ZRRE -së duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Obligohet i licencuari që pas pranimit të këtij Vendimi menjëherë të publikojë dokumentin "Bilanci Vjetor i Energjisë Termike - 2017" në faqen elektronike zyrtare të tij.
- III. Duke pasur parasysh ndikimin e parametrave të ndryshëm të bilancit në përcaktimin e tarifave, ZRRE mban të drejtën që gjatë shqyrtimit tariforë të përshtatë të dhënat që përmban Bilanci vjetor i energjisë termike.
- IV. Në zbatim të nenit 42, paragrafi 2.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) do të monitoroj implementimin e Bilancit Vjetor të Energjisë Termike për të verifikuar realizimin e të dhënave dhe informatave të paraqitura në këtë Bilanc.



- V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së.
- VII. Ky Vendim publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku gjithashtu do të publikohet edhe Bilanci unik i energjisë elektrike dhe energjisë termike.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Krenar Bujupi, U.D. Kryesues

Arsim Janova, Anëtar

Besim Sejrija, Anëtar

Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:

Bilanci Vjetor i Energjisë Termike – 2017, NQ Gjakova

Vendimi ju dërgohet:

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së